



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1041_10_13**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 31.10.2013.

në seancën e mbajtur më datë 20 dhjetor 2013, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin F.M., (shifra e konsumatorit DPR - 9081690) nga Fushë Kosova ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1041_10_13 i datës 10.10.2013.

Arsyetim

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 05.11.2012 kanë bërë pranimin e instalimit të njehsorit elektrik nr. 45872111 me gjendje: TL=10555 kW (tarifa e lartë) dhe TU=11404 kW (tarifa e ulët).

Departamenti i faturimit në KEK me datë 07.12.2012 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike nëntor 2012, në vlerë 1,896.75 €.

Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturat nëntor 2012 për shkak të grumbullimit të shpenzimit.

Departamenti për Konsumator në KEK me datë 23.03.2013 i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se korrigjimi bëhet për shkak të vonesës së regjistrimit për lidhje të re (faturat 12/2011 e deri 11/2012).

Konsumatori pas përgjigjes së KEK-ut ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 10.10.2013 ka nxjerr vendim duke e aprovuar ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që të korrigjoj faturën 11120DPR-90081690 e datës 07.12.2012 në vlerë (844.87€) duke bërë shpërndarjen e kW për periudhën prej 08/2009 e deri më 11/2012.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, me datë 27.09.2013 KEDS-i ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së ndaj këtij vendimi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se nuk ka bazë për korrigjim të faturës së muajit nëntor 2012 ngase KEDS-i në rastin e konsumatorit ka bërë shpërndarjen për një vit



mbrapa ku si korigjim ka dalur shuma prej (-486.16€), ndërsa sa i përket shpërndarjes prej periudhës 08/2009 KEDS-i ka gabuar ngase nuk ka kompetencë të shqyrtojë ankesa jashtë kërkesës së konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2013 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut, përkatësisht bazën e kundërshtimit, me të cilën pretendohet se DMK, gjatë vendosjes së kësaj çështje nuk ka vlerësuar mirë provat dhe faktet e prezantuara. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se sipas procesit të pranimit të instalimit të njehsorit elektrik të datës 05.11.2012 gjendja e njehsorit elektrik ka qenë: TL=10555 kW dhe TU=11404 kW, që nënkupton se ai njehsor ka qenë duke regjistruar energji elektrike edhe më herët dhe se fatura e muajit 11/2012 e cila i ka arritur konsumatorit si shpenzim mujore është grumbullim i shpenzimit të energjisë elektrike, dhe se edhe vet KEK-u ka bërë korigjimin e kësaj fature duke bërë shpërndarjen e shpenzimit për një vit mbrapa, por që duke mos dhënë sqarime se pse është kthyer një vit.

Bordi i ZRRE-së pas vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës e posaçërisht shpenzimit të energjisë elektrike ka vërejtur se sipas të bëra shpenzimeve të energjisë elektrik të konsumatorit me shifër DPR – 90081690 vërehet se në muajin nëntor 2012 është faturuar konsumatori me shpenzim prej **21,959 kWh** si shpenzim mujor, ndërsa shuma e përgjithshme e shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 12/2012 e deri më 08/2013 është 5480 kWh (periudha 10 mujore). Andaj shpenzimi i faturuar i konsumatorit nga KEK-u për muajin nëntor 2012 është shpenzim i grumbulluar dhe nuk paraqet shpenzim mujor, madje edhe vet KEK-u ke pranuar se kemi grumbullim të shpenzimit dhe ka bërë një korigjim konsumatorit duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të evidentuar në procesin e instalimit të njehsorit elektrik (TL=10555 kW dhe TU=11404 kW) për periudhën prej 12/2011 e deri më 11/2012. Sipas mesatares së shpenzimit të energjisë elektrike prej periudhës 12/2012 deri më 08/2013 (periudha pas 11/2012) vërehet se është 548 kWh/muaj, vërehet se shpenzimi i regjistruar në muajin 11/2012 ka qenë që nga periudha 08/2009, andaj edhe duhet t'i bëhet korigjimi i faturës duke bërë shpërndarjen nga periudha 08/2009 e deri më 11/2012.

Sa i përket pretendimit të KEDS-it se nuk ka kompetencë të shqyrtoj jashtë kërkesës së konsumatorit, duhet theksuar se në ankesën e konsumatorit është potencuar se kërkohet shpërndarja e shpenzimit sipas një mesatare prej kur e kam vendosur njehsorin para tre viteve. Andaj Bordi i ZRRE-së thekson qartë se ankesa e konsumatorit ka qenë të bëhet shpërndarja e shpenzimit prej momentit kur është vendosur njehsori elektrik e cila sipas konsumatorit ka qenë përafro tre viteve.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 20.12.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1041_10_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmime tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nixirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar